



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	23.05.2025
REFERENC-Ë:	1055-2/25 - ZSP 2025 ; ARPL 2025
PËR/ZA/TO:	Halim BEHRA, K. Prizren
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Izedin BYTYQI, U.D. - Sekretar i Përgjithshëm MMPHI-së; Z. Fatos QERIMI, Drejtori ARPL-së
	Myvedete MUJA, Zyrtare e lartë, ARPL
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim - Pelqim Ujor

Të nderuar,

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore pranë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar kërkesën me nr. të protok. 1055-2/25, nga pala, Z. Halim BEHRA , K. Prizren, për kalim mbi pronë ujore, dhe ka vendosur si në Vendim, Pëlqim Ujor, të bashkangjitur kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr. P.U.

Datë: 23.05.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjensive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019, Shtojcës 1 pika 10 të Rregullores Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L -147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L - 031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nxjerrë këtë:

PELQIM UJOR

APROVOHET kërkesa e palës, Z Halim BEHRA për **PËLQIM UJOR**, për kalim mbi pronë ujore, me nr P- 71813068-11053-1, nga prona private. P- 71813068-05110-1, Z.Kadastrale K. Prizren;

Nën Kushtet si në vijim:

1. Pëlqimi Ujor lëshohet për kalim të lirë mbi pronën ujore, nr. P-71813068-11053-1, P.Sh. Ujërat, nga prona private e palës, me nr.ngastres P-71813068-05110-1, Zona Kadastrale Prizren, K.Prizren, bazuar në dokumentacionin investivo-teknik i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe si i tillë ruhet nga pala;
2. Kalimi mbi pronën ujore, bëhet vetëm për pjesën, respektivisht në gjërësi prej 4.0 m' në vendin e paraparë si në situacion;

3. Pala duhet të ketë parasysh se, kalimi i lire nuk do të thotë se prona mund të kalojë në pronësi të palës, si dhe përveq kalimit nuk duhet të ketë destinim tjetër, pra duhet të ruaj funksionalitetin aktual, duke mos ndërtuar infrastruktur tjetër, përveq se asaj të kalimit etj;
4. Në pjesën tjetër të pronës ujore, nuk lejohet ndërtim, apo çfarëdo llojë aktiviteti tjetër të paraparë, që nënkupton shfrytëzim;
5. Pëlqimi vlen vetëm për kalim mbi pronën ujore, ndërsa për kyçje në rrugën publike, duhet të siguroj pëlqim nga organi kompetent për Infrastruktura rrugore.
6. Pala duhet të ketë parasysh, se me rastin e hartimin e Planit të Menagjimit të Resurseve ujore, nëse do të vendoset për kushte tjera, ndryshe nga rasti, duhet të adaptohet atyre, sipas kërkesave të nevojshme, pa ndonjë kompensim;
7. Nëse pala do të ndërton në pronën e vet, afër pronës ujore, atëherë duhet të rrespektoj distancën e lejuar e cila në këtë rast duhet të jetë pesë (5) metra nga shtrati i ujërrjedhës, bazuar në legjislacionin e ujërave, respektivisht nenit 5, të Udh. adm, MMPH-Nr. 05/2016;
8. Pëlqimi ujqor ka afatin kohorë prej 2 viteve, nese deri atëherë nuk e ka filluar ndërtimin.

Arsyetim

Pala, Z. Halim BEHRA, K. Prizren, ka bërë kërkesë, me nr. prot. 1055/25, lidhur me mundësin e kalimit mbi Pronën Ujore, me nr. P- 71813068-11053 -1, Zona Kadastrale Prizren, K. Prizren, nga prona private, me nr. P- 71813068-05110-1; Kërkesës i ka bashkangjitur: Pegesën me rastin e aplikimit, bazuar në shtojcën 6 të Udh. Adm 03/2018 për procedura për leje ujore; me nr.000300; “ Studimin hidrologjik dhe hidraulik dhe llogaritjen e plotave shumëvjeçare”; Vendimi i hartuar i nënshkruar nga pronari i pronës dhe vulosur nga hartuesi i dokumentacionit tekniko –investiv; Kopja e lejes ujore e aplikuesit; Kopja e planit dhe Certifikata e Pronësisë për ngastren, me nr. P-71813068-05110-1, në emer të aplikuesit; Certifikate e biznesit e “Prospekt Studio” sh.p.k. , e hartuesit të dokumentacionit tekniko investiv; Licenca, me nr. 195, e hartuesit të planit të situacionit, nënshkruar dhe vulosur nga i njëjti, Z. Burim Halilaj; Licenca A –Inxhinier i licencuar z. Rijad Zejneli, master i shkencave teknike të nder. , drejtimi hidroteknike e hartuesit të projektit

Verejtje : Bazuar në pronocimin e drejtorit, duke u bazuar në takimet që kemi pasur dhe informatat faktike që ju kanë ofruar nga unë si zyrtarë përgjegjës, si dhe sqarimin që ka bërë udhëheqësja e DMRU-së, lëndët janë procesuar për nënshkrim, të cilat ishin në përfundim të procedurës. Andaj bazuar në kërkesën, bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, si dhe dok. shtesë të kërkuar, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 1055-2/25 - ZSP- 2025 Datë: 23.05.2025

Prishtinë

T'i dërgohet:

- Palës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Komunës Prizren;
- Arkivit të Ministrisë.

U.d. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së



Izedin BYTYQI